

# RELACION

## PËR

### **AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.97/2023, “PËR BUXHETIN E VITIT 2024”, TË NDRYSHUAR”**

#### **A. MËNYRA E NDËRHYRJES**

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet, si më poshtë vijon<sup>1</sup>:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:**

Neni 101 ka parashikuar “nevojën” dhe “urgjencën”, si rrethana dhe situata fakti, që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave, pas vlerësimit të ecurisë së treguesve fiskalë, përgjatë gjysmës së parë të vitit 2024, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të dytë të buxhetit për vitin 2024. Ky rishikim ka për qëllim primar reflektimin në buxhetin vjetor të disa rishikimeve në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të cilat synojnë përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2024, të tilla si:

- nevoja për përditësimin e projeksioneve të të ardhurave tatimore për periudhën 2024-2026, si rezultat i:
  - rritjes së të ardhurave përgjatë 7-mujorit të vitit 2024, përtej programimit fillestar, sa kohë që ky programim bazohej në rritjen ekonomike dhe

---

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

indeksin e çmimeve, sipas PBA-së 2024-2026 dhe në efektet e paketës fiskale 2024 dhe ato të mirëadministrimit tatimor. Bazuar në këto parashikime, të ardhurat tatimore në planin fillestar 2024, u rritën me 10% kundrejt 2023;

- vendimit të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizoi përcaktimin ligjor, i cili përfshinte në skemën e taksimit edhe shërbimet profesionale, duke filluar nga 1 janari 2024. Për këtë arsye, plani i të ardhurave për vitin 2024, edhe pse ende i parashikuar në rritje referuar pritshmërive, do të duhet të axhustohet me minus 3 miliardë lekë, vetëm referuar efektit të vlerësuar të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të sipërcituar.
- shtesa e fondeve për KQZ-në, me qëllim avancimin në vitin 2024 të procedurave të prokurimit për zgjedhjet e përgjithshme 2025 dhe garantimin kësisoj të implementimit në kohë të fondeve buxhetore për këtë proces.
- shtesa e fondeve për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zvillimit Rural për implementimin e skemës së re të investimeve për fermerët, me qëllim rritjen e prodhimit, agropërpunimit, si edhe rritjen e eksporteve.
- akomodimi në buxhetin e Ministrisë së Brendshme i efektit financiar, në zbatim të marrëveshjes përkatëse Shqipëri-Itali, për protokollin për emigracionin etj.

## **2. Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ, me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## **B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTI**

Ky rishikim i buxhetit 2024, i cili propozohet t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, parashikon:

- rritjen me rreth 27.3 miliardë lekë të të ardhurave buxhetore, nga të cilat:
  - të ardhurat nga tatime e dogana rriten me +9.4 miliardë lekë;

- të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore rriten me +1.7 miliardë lekë;
  - të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore rriten me +8 miliardë lekë (efekt neutral), bazuar në performancën e realizimit të tyre në buxhetin e vitit 2023, e cila ka vijuar pozitive edhe përgjatë muajve janar-maj 2024, duke krijuar kështu besimin e justifikuar për vazhdimësinë e këtyre ritmeve edhe për pjesën tjetër të vitit 2024 dhe, rrjedhimisht, propozimin për përditësimin në rritje të planit vjetor të tyre në këtë akt normativ;
  - të ardhurat jotatimore rriten me +8 miliardë lekë. Kjo, pasi nga gjendja e disponueshme prej rreth 12.8 miliardë lekësh e llogarisë së shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë propozohet kthimi në buxhet, si të ardhura i një pjese të saj, me qëllim sigurimin e hapësirës së nevojshme të financimit për prioritetet e buxhetit, në kushtet kur disponueshmëria e kësaj llogarie aktualisht i tejkalon pritshmëritë e përdorimit.
- rritjen e shpenzimeve buxhetore me rreth 27.3 miliardë lekë, në të njëjtën masë si të ardhurat.
  - ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor, në nivelin 57.28 miliardë lekë.

Është me rëndësi të nënvizohet, se të gjitha ndryshimet që propozohen mbështeten në një sërë faktorësh realë dhe projeksionesh të pritshme, të cilat garantojnë zbatueshmërinë e tij. Kështu, është thelbësore të përmendet fakti se zhvillimet makrofikscale dhe buxhetore, që shoqëruan mbylljen e vitit buxhetor 2023, u karakterizuan në shkallë të gjerë nga përmirësime të ndjeshme të parametrave të konsoliduar kyç, të cilët vijuan trendin pozitiv edhe përgjatë fillimtvitit 2024, duke krijuar kështu besimin për vazhdimësinë e këtyre ritmeve edhe për pjesën tjetër të vitit.

Ndër të tjera, vlen për t'u veçuar se:

- ekonomia në tërësi gjatë vitit 2023 vazhdoi rritjen duke treguar një stabilizim të aktivitetit ekonomik. Produkti i brendshëm bruto (PBB) për vitin 2023 ka shënuar rritje prej rreth 3.4% krahasuar me vitin 2022, sipas vlerësimit më të fundit të disponueshëm. Kjo rritje u gjenerua, si nga kërkesa e brendshme ashtu edhe ajo e huaj, si rezultat i zgjerimit të konsumit privat, investimeve dhe aktivitetit të turizmit. Momenti pozitiv i rritjes ka vijuar edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit 2024, me rreth 3.63%, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Kërkesa e brendshme mbeti e fortë, veçanërisht konsumi dhe investimet, ku rritja shënoi normat 3.6% dhe 7.7% respektivisht.

- të ardhurat e përgjithshme në 7-mujorin e parë të vitit 2024 janë në shumën 402.514 milionë lekë, me një realizim prej 103% ose +11.6 miliardë lekësh më shumë kundrejt planit të periudhës. Krahasuar me 7-mujorin e vitit 2023, rritja është +8 % ose +30.3 miliardë lekë. Tejkalimi vërehet kryesisht në të ardhurat tatimore që administrohen nga tatimet dhe doganat, të ardhurat tatimore të pushtetit vendor, si dhe në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
  - Të ardhurat nga tatimet e dogana për 7-mujorin 2024 janë 261.5 miliardë lekë, 22.4 miliardë lekë ose 9.4% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Krahasuar me planin, të ardhurat janë +5.2 miliardë ose 2+% më shumë;
  - Të ardhurat nga pushteti vendor për 7-mujorin 2024 janë 24.5 miliardë lekë dhe, krahasuar me 7-mujorin 2023 janë +7.3 miliardë lekë ose 42.5% më shumë. Krahasuar me planin, të ardhurat janë +7.9 miliardë ose 48% më shumë;
  - Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për 7-mujorin 2024 janë në shumën 92 miliardë lekë, 9.6 miliardë lekë ose 11.6% më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Krahasuar me planin, të ardhurat janë +1 miliard lekë ose 1.1% më shumë.
- Borxhi publik në fund të vitit 2023 shënoi nivelin 58.9% të PBB-së, duke u ulur me rreth 5.5pp, krahasuar me fundin e vitit 2023. Ky nivel, i cili është konsiderueshëm më i ulët edhe krahasuar me periudhën para pandemisë (65.8% e PBB-së në vitin 2019), shënon njëkohësisht edhe nivelin më të ulët të regjistruar, që prej vitit 2010 (57.7% të PBB-së).
- Deficiti buxhetor në fund të vitit 2023 shënoi nivelin prej 1.3% të PBB-së. Për periudhën janar-qershor 2024, balanca buxhetore shënoi një vlerë pozitive prej 51.4 miliardë lekësh ose 1.4 herë më shumë se plani (i pandryshuar) i aktit normativ nr.1, datë 21.2.2024.
- Balanca primare në fund të vitit 2023 u rikthye për herë të parë në pozicion pozitiv prej 0.7% të PBB-së, që prej para andemisë. Në vitin 2019 u regjistrua për herë të fundit një nivel pozitiv i balancës primare, prej rreth 0.2% të PBB-së.

## **C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTI**

### **NË KAHUN E TË ARDHURAVE:**

- Të ardhurat tatimore rriten me +19.1 miliardë lekë, nga të cilat:

- të ardhurat e administruara nga tatime/dogana rriten me 9.4 miliardë lekë, bazuar në performancën pozitive të 7-mujorit të vitit 2024, si dhe në vlerësimin e faktorëve të qëndrueshëm pozitivë, që do të impaktojnë të ardhurat e pjesës së dytë të vitit. Rritja ekonomike e qëndrueshme në vitin e kaluar, e cila ka vazhduar edhe në gjysmën e parë të këtij viti, e shoqëruar kjo me rritjen e konsumit të mallrave dhe shërbimeve, rritjen e sektorëve të turizmit dhe ndërtimit, ka rritur të ardhurat e gjeneruara në buxhet;
- të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kanë tejkaluar projeksionet, rezultat ky i rritjes së nivelit të pagës, jo vetëm në sektorin publik por edhe në atë privat, por edhe rritja e numrit të kontribuesve. Për këtë arsye, në këtë akt normativ janë rishikuar me rritje +1.7 miliardë lekë;
- tatimi mbi të ardhurat personale ka ecur me ritme pozitive. Të ardhurat nga tatimi mbi pagën nga sektori publik u realizuan me rritje +21.4%, në krahasim me 7-mujorin e vitit 2023, rritje e cila reflekton rritjen e pagave të ndërmarrë në mesin e vitit të kaluar, ndërsa të ardhurat nga tatimi mbi pagën nga sektori privat u realizuan me rritje +14.9%, në krahasim me 7-mujorin e vitit 2023, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e të ardhurave nga ky tatim. Pavarësisht nga ky trend pozitiv, tatimi mbi të ardhurat personale është parashikuar me ulje për të ardhurat biznesore, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit, i cili fuste në skemën e taksimit nga 1 janari i vitit 2024 shërbimet profesionale. Për këtë arsye, këto të ardhura të projektuara për muajt gusht-dhjetor 2024, rishikohen me ulje me -1.5 miliardë lekë më pak;
- fluksi i pagesave të tatimit mbi fitimin e kompanive, që lidhet me fitimet e vitit 2023, ka tejkaluar parashikimet duke ndikuar në rritjen e të ardhurave nga ky tatim në 7-mujorin e vitit 2024 me mbi 2.2 miliardë lekë kundrejt planit. Kjo tendencë pozitive është reflektuar edhe në rritjen e të ardhurave për 5-mujorin e mbetur, me +1.5 miliardë lekë;
- të ardhurat nga taksat nacionale janë rishikuar me rritje, sepse disa taksa kombëtare që mblidhen nga administrata doganore, në rolin e agjentit tatimor, janë mbledhur dhe arkëtuar në buxhet, por klasifikimi në kontabilitet, si të ardhura të tilla tek administrata tatimore është reflektuar vetëm gjatë muajit gusht të vitit 2024;
- gjithashtu, me rritje janë rishikuar tatimi mbi vlerën e shtuar, taksa doganore e akciza, bazuar në performancën e 7-mujorit.

Kjo performancë pozitive krijon besimin për vazhdimësi pozitive në të ardhurat e buxhetit në 5-mujorin e mbetur të vitit, duke krijuar mundësi për më tepër mbështetje sociale dhe investime.

- Ndërkohë, ky akt normativ propozohet edhe me një rritje të zërit të të ardhurave jotatimore, përkatësisht në masën 8.1 miliardë lekë, që i dedikohet kthimit në buxhet, si të ardhura të një pjese të gjendjes së disponueshme prej rreth 12.8 miliardë lekësh të llogarisë së shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, prej 8 miliardë lekësh. Kjo, duke garantuar natyrisht disponueshmërinë e fondeve të nevojshme për zbatimin e akteve ligjore/nënligjore, tashmë të miratuara dhe atyre të pritshme, me efekte financiare në shpronësime.

## NË KAHUN E SHPENZIMEVE:

Propozimet sa i takon zërave të shpenzimeve buxhetore, ndër të tjera, konsistojnë në:

- financimin shtesë, në masën 5 miliardë lekë, për projektet e reja të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për vitin 2024, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, të cilat konsistojnë në projekte të reja në programe zhvillimi, të infrastrukturës vendore e rajonale dhe programit 100 fshatrat;
- financimin shtesë, në masën 4.75 miliardë lekë, për projektet e reja të transportit rrugor për vitin 2024, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, për financimin e projektit të rrugës Elbasan-Lekaj, Fier-Kthesa Patos-Frataj dhe Bërdicë-Unaza Lindore;
- financimin shtesë, në masën 2 miliardë lekë, për projektet e reja në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitin 2024, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, për projektet “Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve të njësisë administrative Hudënisht, Bashkia Pogradec”, “Optimizimi i ujësjellësit të Vorës dhe rrethinat”, “Sistemi i ri KUZ+ITUP në zonën turistike të Spillesë, Bashkia Kavajë”, ujësjellësa në zona turistike etj;
- financimin shtesë, në masën 250 milionë lekë për vitin 2024, për projektin e regjistrimit të zgjedhësve në diasporë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me qëllim avancimin në vitin 2024 të procedurave të prokurimit për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 dhe garantimin e implementimit në kohë të sistemit;
- financimin shtesë, në masën 400 milionë lekë, për projektet e reja dhe në vazhdim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2024, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, të cilat konsistojnë në projekte në sektorin e ujitjes dhe kullimit;
- financimin shtesë, në masën 223 milionë lekë për vitin 2024 në Ministrinë e Financave, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, për projektet e reja të sistemit të thesarit dhe serverave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për shkak të urgjencave dhe problematikave të krijuara;

- financimin shtesë, në masën 250 milionë lekë, për projekte të reja në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, për financimin e projekteve, në vlerën 50 milionë, në programin “Shërbimi i kujdesit parësor” dhe 200 milionë lekë në programin “Shërbimi i kujdesit dytësor”;
- financimin shtesë, në masën 240 milionë lekë për vitin 2024 në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Invoacionit, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, për projektet e reja të arsimit të mesëm profesional;
- financimin shtesë, në masën 160 milionë lekë, për projektet e reja në Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2024, reflektuar edhe për vitet 2025-2026, për financimin e projektit të Paraburgimit Kukës;
- financimin shtesë, në masën 173 milionë lekë, për projektet e reja në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme për financimin e veprimtarisë së ambasadave/konsullatave të reja, të krijuara gjatë vitit 2024;
- financimin shtesë, në masën 100 milionë lekë, për projektet e reja në Ministrinë e Brendshme, në zbatim të marrëveshjes Shqipëri-Itali për protokollin për emigracionin;
- shtesën e fondeve për institucionin e Autoritetit Kombëtar për Sigurisë Kibernetike, në masën 1.5 miliardë lekë, në kuadër të procesit të implementimit të “Platformave me teknologji të avancuar, që shfrytëzojnë inteligjencën artificiale në fushën e sigurisë kibernetike, për sistemet dhe infrastrukturat qeveritare të vendit”, përcjellë me shkresën “sekret” nr.25, datë 27.6.2024, dhe rikonfirmuar me shkresën nr.26/1, datë 14.8.2024, të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;
- shtesën e fondeve, në masën 1.3 miliardë lekë dhe 500 efektivë të rinj për Ministrinë e Brendshme, me qëllim përballimin e nevojave 12M për kompensimin ushqimor, krahas orëve jashtë orarit, në kuadër të sezonit intensiv turistik dhe efektit financiar, në zbatim të marrëveshjes së re Shqipëri-Itali për protokollin për emigracionin;
- shtesën e fondeve, në masën 500 milionë lekë për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zvillimit Rural, në mbështetje të fermerëve për implementimin e skemës së re të mbështetjes/grand për investime, e cila synon të krijojë iniciativë për rritjen e investimeve në sektorin e bujqësisë, me qëllim rritjen e prodhimit, agropërpunimit dhe eksporteve. Shtesa e propozuar nevojitet për të mbuluar rreth 20-30% të aplikimeve, të cilat i korrespondojnë periudhës gusht-dhjetor 2024;
- shtesën e fondeve, në masën 690 milionë lekë për Ministrinë e Mbrojtjes, nga të cilat 150 milionë lekë, si kapital fillestar për shoqërinë “KAYO”, sh.a., 290 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ndërmarrjeve ekzistuese, 150 milionë lekë për AKMC-në për pagesën e dëmshpërblimeve të mbartura nga fatkeqësitë natyrore dhe 100 milionë për nevoja të Spitalit të Traumës;

- shtesën e fondeve, në masën 450 milionë lekë për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim plotësimin e tavaneve buxhetore 2024, sipas nevojave të evidentuara deri në këtë moment në zërin “Shpenzime personeli” rreth 210 milionë lekë, financimin e projekteve komunitare të KOKSH-it rreth 150 milionë lekë dhe shpërblimin e sportistëve elitare 90 milionë lekë;
- shtesën e fondeve, në masën 80 milionë lekë për RTSH-në, me qëllim financimin e nevojave lidhur me shërbimet për disporën, prodhimet filmike e artistike dhe orkestrën simfonike;
- etj.

## NË ASPEKTIN E DEFICITIT DHE BORXHIT PUBLIK:

- Deficiti buxhetor, si rrjedhojë e ndryshimeve të mësipërme në të ardhura dhe shpenzime mbetet i njëjtë, sipas atij të miratuar me anë të aktit normativ nr.1, datë 21.2.2024.
- Borxhi publik për buxhetin 2024 rishikohet duke reflektuar ndryshimet, si më poshtë vijon:
  - Financimi nëpërmjet kredive të huaja, në formën e mbështetjeve buxhetore, rritet me rreth 3.2 miliardë lekë, duke reflektuar disbursimin e pritshëm të paradhënies së mbështetjes së Bashkimit Evropian, që do të akordojë për vendet e Ballkanit Perëndimor, në kuadër të planit të rritjes;
  - Në shpenzimet e parashikuara për interesat e borxhit gjatë vitit 2024 vlerësohet të ketë një kursim, në vlerën prej 2 miliardë lekësh, në interesat e jashtme, kryesisht si rezultat i efektit të kursit të këmbimit;
  - Gjithashtu, zëri i ripagesave të borxhit të jashtëm rishikohet me një ulje prej rreth 6.8 miliardë lekësh, po si rezultat i efektit të kursit të këmbimit, si dhe të mosmaterializimit të pagesave të mundshme, të parashikuara për t’u kryer nga Ministria e Financave për kredi të garantuara, pagesa të cilat janë kryer nga vetë huamarrësi.

Nisur nga sa është parashtruar më sipër, theksohet se ndryshimet e propozuara në këtë akt normativ do të vijnë të garantojnë trajektoren rënëse të nivelit të borxhit publik, në raport me PBB-në, në përputhje me rregullin respektiv fiskal, të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit, duke siguruar kështu vijimësinë e konsolidimit fiskal dhe qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike dhe stabilitetin makroekonomik në tërësi.

Në vijim të porosisë së lënë në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave, të datës 28.8.2024, akti normativ është ripunuar, duke reflektuar të gjitha



ndryshimet e kërkuara, të cilat janë pasqyruar në përmbajtje të tabelave përkatëse, pjesë përbërëse të tij.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**